

**VENDIM**  
**Nr. 695, datë 9.9.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.7.2016, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE KËMBËSORIE TË  
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME MISION  
NË KOMANDËN E TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE NDIHMËS NË HERAT, NË  
KUADËR TË OPERACIONIT TË NATO-s “RSM”, AFGANISTAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fjalja e parë, e pikës 4, të vendimit nr. 513, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 10 dhjetor 2021.”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**